



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVA
QEVERIA E KOSOVËS / VLADA KOSOVA / GOVERNMENT OF KOSOVA

MINISTRIA E BUJQËSISË, PYLLTARISË DHE ZHVILLIMIT RURAL
MINISTARSTVO POLJOPRIVREDE, ŠUMARSTVO I RURALNOG RAZVOJA
MINISTRY OF AGRICULTURE, FORESTRY AND RURAL DEVELOPMENT

Në pajtim me dispozitat e Ligjit për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, neni 12, paragrafi 4, Ministria e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural bën :

REKRUTIM

I.

Titulli i vendit të punës: Bashkëpunëtor profesional për Analizat e Ushqimit për Kafshë
Ref: IBK -26/18 MSHV
Departamenti : Instituti Bujqësor i Kosovës
Koeficienti : 7
Vendi i punës : Pejë
Lloji i kontratës: “Marrëveshje për Shërbime të Veçanta” kohëzgjatje 6 muaj

Detyrat e punës:

1. Pranimi i mostrave nga udhëheqësi i Laboratorit Analitik, regjistrimi i tyre në Librin e Protokollit të Punës së Laboratorit dhe lëshon Raporte Laboratorike konform procedurave të Manualit të Cilësisë të Institutit Bujqësor të Kosovës dhe kritereve të DAK-ut,
2. Përgatitja e mostrave të ushqimit për kafshë për testim analitik, varësisht llojit të analizës së kërkuar dhe konform manualeve të kritereve të standardit ndërkombëtar ISO 17025,
3. Testimi analitik laboratorik i mostrave të gjitha llojeve të ushqimeve për kafshë, për parametrat analitik sikurse janë: Lagështia, Proteinat, Yndyrat, Celuloza, Hiri, P, K, Ca, Na, Mg, Cu, Zn, B, Fe dhe Mn,
4. Monitorimi dhe menaxhimi i pajisjeve laboratorike dhe reagjentëve kimik në funksion të aktiviteteve rutinë për kryerjen e analizave laboratorike të ushqimeve për kafshë sipas standardit ndërkombëtar ISO 17025,
5. Kontrollon zhvillimin e procedurave të analizave laboratorike në zbatim të standardit ndërkombëtar të BE-së ISO 17025 për testimin analitik të ushqimeve për kafshë,
6. Hulumtimin e metodave dhe teknologjive laboratorike më inovacion për testimin analitik të ushqimeve për kafshë,
7. Kontaktet Online më laboratorët regjional dhe ndërkombëtar, lidhur më standardizimin e procedurave të testeve analitike për parametra të caktuar dhe organizon pjesëmarrjen e laboratorit të ushqimeve për kafshë në Testet Krahasuese Ndër Laboratorike.

Kualifikimet dhe përvoja:

-Diplomë e Fakultetit të Kimisë apo relevante
-Përvojë pune 2 vite

II.

Titulli i vendit të punës: Bashkëpunëtor profesional për Koordinim mes Administratës dhe Menaxhimit të Cilësisë

Ref: IBK - 27/18 MSHV

Departamenti : Instituti Bujqësor i Kosovës

Koeficienti : 7

Vendi i punës : Pejë

Lloji i kontratës: “Marrëveshje për Shërbime të Veçanta” kohëzgjatje 6 muaj

Detyrat e punës:

1. Siguron mbështetjen e gjithanshme administrative për përgatitjen e dokumentacionit për menaxhimin e Manualit të Cilësisë në Institutin Bujqësor të Kosovës, si në vijim:
2. Përpilon dokumentacionin për përgatitjen dhe përditësimin e Manualit të Cilësisë konform udhëzimeve të Menaxherit për Menaxhimin e Cilësisë,
3. Përpilon dokumentacionin e manualeve për kërkesat e akreditimit dhe ri akreditimit të brendshëm, për procedurat e gjithë parametrave analitik që analizohen në kuadër të laboratorëve të Institutit Bujqësor të Kosovës,
4. Përpilon dokumentacionin e manualeve të kërkesave për akreditimin ndërkombëtar të laboratorëve të Institutit Bujqësor të Kosovës,
5. Përpilon dokumentacione për Menaxherin e Menaxhimit të Cilësisë në kuadër të Institutit Bujqësor të Kosovës,
6. Kryen procedurat administrative për urdhëresat e punëve për punonjës të laboratorëve dhe siguron anonimin e mostrave për stafin teknik të laboratorëve,

Kualifikimet dhe përvoja:

- Diplomë e Fakultetit të Ekonomik ,Juridik
- Përvojë pune 2 vite
- Njohja e gjuhës angleze

III.

Titulli i vendit të punës: Bashkëpunëtor profesional për Organizimin e Manualeve të ISTA-së në Laboratorin e Farërave
Ref: IBK - 28/18 MSHV
Departamenti : Instituti Bujqësor i Kosovës
Koeficienti : 7
Vendi i punës : Pejë
Lloji i kontratës: “Marrëveshje për Shërbime të Veçanta” kohëzgjatje 6 muaj

Detyrat e punës:

1. Siguron që testimet analitike për kontrollin e kualiteti të farërave që kryhen pranë Laboratorit të Kontrollit të Kualitetit të Farërave janë në përputhje të plotë me Manualin e Organizatës Ndërkombëtare për Testimin e Kualitetit të Farërave – ISTA-së,
2. Siguron zbatimin e kriterëve konform manualeve të standardit ndërkombëtar ISTA gjatë procedurave për testimin e parametrave analitik gjatë kontrollit të kualitetit të farërave, si dhe për akreditimin ndërkombëtar të Laboratorit të Farërave,
3. Siguron përkthimin e manualeve të standardit ndërkombëtar ISTA dhe mundësimin e aplikimit të tyre për punën rutinë të stafit teknik në Laboratorin e Farërave,
4. Bënë kërkesa për asistencë teknike pranë projektit të Komisionit Evropian – TAIEX dhe ndihmon pjesëmarrjen e stafit teknik të Laboratorit të Farërave në vizita studimore jashtë vendit,
5. Siguron hulumtimin e metodologjive të reja dhe teknologjive inovative për zgjerimin e gamës së testimit analitik laboratorik të kontrollit të kualitetit të farërave,
6. Siguron zhvillimin e konkurrueshmërisë së Laboratorit të Farërave konform standardeve të zhvillimit të laboratorëve homolog të vendeve të zhvilluara dhe të BE-së,
7. Do të mirëmbaj dhe azhurnoj Web Faqen Zyrtare të Institutit Bujqësor të Kosovës lidhur me punën e Laboratorit të Farërave,

Kualifikimet dhe përvoja:

- Diplomë e Fakultetit të Bujqësisë ose ekuivalente
- Përvojë pune 2 vite
- Njohja e gjuhës angleze

IV.

Titulli i vendit të punës: Bashkëpunëtor profesional për Ekstrahimin e Mostrave të Mbetjeve Kimike
Ref: IBK - 29/18 MSHV
Departamenti : Instituti Bujqësor i Kosovës
Koeficienti : 7
Vendi i punës : Pejë
Lloji i kontratës: “Marrëveshje për Shërbime të Veçanta” kohëzgjatje 6 muaj

Detyrat e punës:

1. Pranimi dhe regjistrimi i mostrave në Librin e Protokollit të Punës pranë Laboratorit të Mbetjeve Kimike,
2. Sipas nevojës eventuale dhe ekskluzive siguron marrjen e mostrave në terren për testimin e niveleve të lejuara të mbetjeve të ndotësve kimik konform standardit ndërkombëtar ISO 17025,
3. Ekstrahimi ose përgatitja e mostrave të llojeve dhe produkteve të ndryshme ushqimore, për testimin e niveleve të lejuara të mbetjeve të metaleve të rënda,
4. Ekstrahimi ose përgatitja e mostrave të llojeve dhe produkteve të ndryshme ushqimore, për testimin e niveleve të lejuara të mbetjeve të pesticideve,
5. Ekstrahimi ose përgatitja e mostrave të llojeve dhe produkteve të ndryshme ushqimore dhe tokave, për testimin e niveleve të lejuara të mbetjeve të Dioxinave,
6. Ekstrahimi ose përgatitja e mostrave të llojeve dhe produkteve të ndryshme ushqimore, për testimin e vitaminave, me theks testimin e acidit folik në mostrat e miellit,
7. Ekstrahimi ose përgatitja e mostrave të llojeve dhe produkteve të ndryshme ushqimore, për testimin e niveleve të lejuara të mbetjeve të Bifenileve.

Kualifikimet dhe përvoja:

- Diplomë e Fakultetit të Kimisë ose ekuivalente
- Përvojë pune 2 vite
- Njohja e gjuhës angleze

V.

Titulli i vendit të punës: Bashkëpunëtor profesional për Baroja të Këqija në
Laboratorin e Bimëve
Ref: IBK - 30/18 MSHV
Departamenti : Instituti Bujqësor i Kosovës
Koeficienti : 7
Vendi i punës : Pejë
Lloji i kontratës: “Marrëveshje për Shërbime të Veçanta” kohëzgjatje 6 muaj

Detyrat e punës:

1. Pranimi dhe regjistrimi i mostrave të barojave të këqija në Librin e Protokollit të Punës në Laboratorin e Mbrojtjes së Bimëve,
2. Vlerësimi dhe klasifikimi anatomik për mostrat e barojave të këqija në terren dhe laborator, si dhe nxjerrja e Raporteve Laboratorike mbi determinimin anatomik dhe fazës së zhvillimit të tyre,
3. Puna kërkimore shkencore për inventarizimin e barojave të këqija në territorin e Republikës së Kosovës,
4. Puna kërkimore shkencore për krijimin e koleksionit dhe bankës së gjeneve për barojat e këqija në nivel vendi,
5. Hulumtimi analitik për ndalimin e depërtimit të barojave të këqija nga vendet e ndryshme dhe që nuk shtrihen (që nuk ekzistojnë ose jetojnë) në vendin tonë,
6. Përshkrimi i përqindjes së prezencës së barojave të këqija për metër katror, si dhe vlerësimi i shkaktimit të dëmeve ekonomike në sipërfaqe të kultivuara më kultura bujqësore, pemë frutore dhe vreshta,
7. Hulumtimi i metodologjive për luftimin e barojave të këqija, varësisht prej qëllimit të kultivimit, konvencional ose organik,

Kualifikimet dhe përvoja:

- Diplomë të Fakultetit të Bujqësisë ose ekuivalent,
- Përvojë pune
- Njohja e gjuhës angleze

VI.

Titulli i vendit të punës: Bashkëpunëtor profesional për Bromatologji në
Laboratorin e Farërave

Ref: IBK - 31/18 MSHV

Departamenti : Instituti Bujqësor i Kosovës

Koeficienti : 7

Vendi i punës : Pejë

Lloji i kontratës: “Marrëveshje për Shërbime të Veçanta” kohëzgjatje 6 muaj

Detyrat e punës:

1. Pranimi dhe regjistrimi i mostrave në Librin e Protokollit të Punës për testimin e përpunimit teknologjik të farërave për prodhimin e bukës pranë Laboratorit të Kontrollit të Kualitetit të Farërave,
2. Kryen përgatitjen e lëndëve ndihmëse për përgatitjen e brumit në kushte laboratorike,
3. Harton manuale për zhvillimin e qëndrueshëm të Laboratorit të Bromatologjisë në kuadër të Laboratorit të Farërave,
4. Hulumton cilësinë e prodhimit të miellit të farërave të drithërave konform përbërjes kimike të tyre,
5. Mundëson hulumtimin e kualitetit të varieteteve të drithërave për qëllim të seleksionimit dhe përmirësimit gjenetik të tyre,
6. Hulumton zhvillimin e metodologjive të reja konform standardeve ndërkombëtare për bromatologji,
7. Zbaton teknologjitë e inovacioni laboratorik në fushën e bromatologjisë,

Kualifikimet dhe përvoja:

-Diplomë Univerzitare për Teknologji Ushqimore ose ekuivalente,

-Përvojë pune 2 vite

-Njohja e gjuhës angleze

VII.

Titulli i vendit të punës: Depoist për Material Laboratorik dhe Fushor
Ref: IBK - 32/18 MSHV
Departamenti : Instituti Bujqësor i Kosovës
Koeficienti : 6
Vendi i punës : Pejë
Lloji i kontratës: “Marrëveshje për Shërbime të Veçanta” kohëzgjatje 6 muaj

Detyrat e punës:

1. Pranon, sistematizon, menaxhon dhe shpërndan materialet për furnizimin e laboratorëve më reagjent kimik dhe qelqurina,
2. Pranon, sistematizon, menaxhon dhe shpërndan inputet bujqësore për furnizimin e fermës eksperimentale,
3. Pranon, sistematizon, menaxhon dhe ruan mostrat e produkteve të ndryshme pas përfundimit të analizave të tyre, për periudhë të caktuar konform standardit ndërkombëtar ISO 17025, EPPO, ISTA dhe OECD,
4. Mirëmban regjistrat për hyrjen dhe daljen e materialeve shpenzuese dhe inputeve bujqësore të depove,
5. Mirëmban higjienën dhe kushtet ambientale të depove për ruajtjen e reagjentëve kimik, ruajtjen e inputeve bujqësore dhe ruajtjen e mostrave pas testimeve analitike,
6. I përgjigjet Zyrtarit të Lartë për Administratë dhe Menaxherit të Cilësisë.

Kualifikimet dhe përvoja:

- Shkolla e mesme, apo e Lartë ,
- Përvojë pune 1 vit

Data e shpalljes: 14.12.2018

Data e mbylljes: 18.12.2018

Shërbimi Civil i Kosovës i shërben të gjithë popullit të Kosovës, dhe mirëpret aplikacionet prej meshkujve dhe femrave të të gjitha komuniteteve kosovare.

Aplikacionet e pakompletuara nuk do të meren parasysh. Vetëm kandidatët që hyjnë në listën e përzgjedhur do të informohen. Dokumentet duhet të jenë fotokopje përndryshe nuk kthehen.

Procedura e Aplikimit: Formularët për aplikim mund të mirren dhe dorëzohen në Institutin Bujqësor të Kosovës në Pejë